

## **Cilat janë të drejtat e mia si një viktimë e një vepre penale?**

Asnjëri nuk është i përgatitur që të bëhet viktimë e një vepre penale.

Pavarësisht, nëse bëhet fjalë për një vjedhje çante, një plagosje të rëndë trupore ose një vepër tjetër penale: Njeriu ndoshta është i lënduar ose i tronditur nga vepra penale dhe shpesh herë ai nuk di pastaj se çfarë duhet të bëjë.

Kjo fletë udhëzuese duhet t'ju japë një pasqyrim të parë se ku mund të gjeni ndihmë në këtë situatë dhe cilat të drejta keni.

### **Kush mund të më ndihmojë?**

Këshillim dhe ndihmë ofrojnë institucione për viktimat. Në qendrat e këshillimit punojnë persona të kualifikuar në mënyrë të veçantë, të cilët kanë shumë përvojë me njerëz në situatën tuaj, dëshirojnë t'ju dëgjojnë dhe t'ju ndihmojnë. Sipas nevojës ata mund t'ju ndërmjetësojnë edhe ndihmë të mëtejshme, p.sh. ndihmë psikologjike ose terapeutike.

Një pasqyrë, se tek kush ju mund të drejtoheni, gjeni këtu: [www.hilfe-info.de](http://www.hilfe-info.de) Natyrisht, ju mund të interesoheni edhe në çdo rajon të policisë.

### **Si mund të denoncoj unë një vepër penale dhe mund të paraqes një kërkesë për fillimin e procedurës penale dhe çfarë ndodh pastaj?**

Nëse ju dëshironi të bëni kallëzim për një vepër penale, ju mund të drejtoheni tek çdo rajon i policisë. Ju mund të paraqisni një kallëzim penal edhe tek prokuroria. Nëse ju keni paraqitur një kallëzim penal, ju nuk mund ta tërhiqni më atë, sepse autoritetet hetimore (policia dhe prokuroria) duhet të hetojnë parimisht në rast të çdo vepre penale të denoncuar.

Vetëm në rast të veprave penale më pak të rënda (si p.sh. fyerje ose dëmtim material) mund të vendosë viktimja, nëse vepra penale ndiqet. Prandaj këto vepra quhen edhe delikte kërkesë: Ndjekja penale bëhet këtu, si rregull, vetëm me kërkesë, pra vetëm atëherë, nëse ju si viktimë e veprës penale e dëshironi këtë shprehimisht. Këtë kërkesë ju duhet ta paraqitni brenda tre muajve, pasi ju keni marrë vesh për veprën dhe personin e autores respektivisht autorit.

### **Po nëse unë nuk e kuptoj ose e kuptoj vetëm me vështirësi gjuhën gjermane?**

Kjo nuk ka rëndësi. Nëse ju dëshironi të paraqisni një kallëzim, atëherë ju do të merrni ndihmë. Nëse ju merreni në pyetje si dëshmitare ose si dëshmitar, ju keni të drejtë që t'ju angazhohet një përkthyes ose një përkthyes. Nëse dëshironi informacione të veçanta dhe nuk e kuptoni mjaftueshëm gjermanishten, ju mund të kërkonit të merrni një njoftim në një gjuhë të kuptueshme për ju.

### **Cilat informacione mund të marr unë mbi procesin penal?**

Nëse ju jeni bërë viktimë e një vepre penale, ju mund të merrni informacione për procesin dhe nga dosja. Thoni, më mirë menjëherë tek policia, nëse ju dëshironi të merrni informacione dhe cilat. Ju mund të merrni këto informacione:

- Ju merrni një vërtetim të shkurtër me shkrim të kallëzimit tuaj penal.
- Juve ju njoftohet, nëse prokuroria e ka pezulluar procesin, d.m.th. nuk ka ngritur padi para gjykatës.
- Ju informoheni se kur dhe ku zhvillohet shqyrtimi gjyqësor dhe për çfarë akuzohet i pandehuri respektivisht e pandehura.
- Juve ju njoftohet rezultati i procesit gjyqësor, d.m.th. nëse ka pasur një vendim pafajësie ose një dënim ose nëse procesi është pezulluar.
- Ju merrni informacione, nëse personi i fajësuar ose i dënuar është në burgim. Këtu përfshihet gjithashtu që ju të informoheni, nëse ky p.sh. merr lejë nga burgu ose është arratisur nga burgu.

- Juve ju njoftohet, nëse i dënuari ose e dënuara është i/e ndaluar që të lidhë kontakt me ju.

Përveç kësaj ju mund të kërkontë në raste të veçanta që të merrni njoftime ose kopje nga aktet. Kjo mund të jetë p.sh., pas një aksidenti rrugor, një skicë e aksidentit, për të cilën ju keni nevojë për të kërkuar zhdëmtim ose shpërbim për dëmin. Nëse ju nuk keni të drejtë për padi dytësore (për padinë dytësore direkt më poshtë në f. 2), ju duhet edhe ta arsyetoni kërkesën, pra duhet të shpjegoni pse ju keni nevojë për këto informacione nga aktet. Përjashtime mund të jenë të mundshme në raste të veçanta.

### **Dëshmia juaj si dëshmitare ose dëshmitar**

Si viktimë e një veprë penale, ju jeni dëshmitare ose dëshmitar dhe prandaj keni shumë rëndësi për procesin. Detyra më e rëndësishme e një dëshmitareje ose dëshmitari është të japë dëshmi të plotë dhe të vërtetë. Ju i ndihmoni shumë autoritetet hetuese, nëse ju për marrjen tuaj në pyetje sillni me vete ndonjë dokument që keni në dispozicion (p.sh. një raport mjekësor ose foto). Si rregull, ju bëni deklarin tuaj tek policia. Në shumë raste ju duhet të deklaroheni më vonë edhe para gjykatës. Vetëm në raste të veçanta, p.sh. ju jeni i/e martuar me personin e akuzuar ose keni lidhje të ngushta farefisnore me atë, ju mund ta refuzoni dëshminë, pra nuk duhet të thoni asgjë.

Gjatë marrjes suaj në pyetje ju duhet të tregoni emrin dhe adresën tuaj. Mund të bëhet një përjashtim, nëse ekziston një rrezikim i veçantë. Kjo mund të ndodhë p.sh., nëse dikush ju ka kërcënuar me dhunë, meqë ju dëshironi të kallëzoni. Atëherë ju nuk duhet të bëni të njohur adresën tuaj private. Në vend të kësaj ju mund të jepni një adresë tjetër, nëpërmjet të cilës ju mund të informoheni. Kjo mund të jetë p.sh. një institucion për ndihmën e viktimave, me të cilin ju jeni në kontakt. Nëse ju dëshmoni para gjykatës dhe personi i fajësuar respektivisht i akuzuar është i pranishëm, nuk do t'ju kërkohet adresa e plotë, por vetëm vendi ku jetoni. Nëse ekziston një rrezik siç u përshkrua më sipër, nuk duhet të tregoni as vendbanimin tuaj.

Të deklaroheni si dëshmitare ose si dëshmitar është me siguri një situatë përjashtimi, e cila mund të jetë shumë ngarkuese. Prandaj ju mund të sillni dikë me vete për marrjen në pyetje. Ky mund të jetë një e afërme ose një i afërm ose edhe një shoqe ose një shok. Ky person mund të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje dhe mund të përjashtohet vetëm në raste përjashtimi. Natyrisht mund të shoqëroheni edhe nga një avokate ose një avokat. Në raste të veçanta një avokate ose një avokat mund t'ju vihet në krahë me shpenzimet e shtetit për kohëzgjatjen e marrjes në pyetje. Nëse ju mendoni që ju për një marrje në pyetje keni nevojë për një mbrojtje të tillë, pavarësisht nëse ajo bëhet nga policia, prokuroria ose gjykata, pyesni para marrjes në pyetje, mundësisht herët, tek ai person që e bën marrjen në pyetje.

### **Shoqërimi psiko-social gjatë procesit**

Që nga viti 2017 në shkallën e federatës ekziston mundësia që në raste të caktuara ju mund të shoqëroheni dhe përkujdeseni profesionalisht (i ashtuquajtur shoqërimi psiko-social gjatë procesit). Në mënyrë të veçantë fëmijë dhe të rinj dhe të reja që janë bërë viktimë e veprave penale të dhunshme ose seksuale kanë një pretendim të tillë. Por edhe viktima të rritura të krimeve të rënda të dhunshme ose seksuale mund të kenë nevojë dhe të marrin një përkujdesje të tillë.

Shoqërimi psiko-social gjatë procesit është falas për viktimën, nëse ai është konfirmuar nga gjykata. Në të gjitha rastet e tjera, ju mund të shfrytëzoni shoqërimin psiko-social të procesit me shpenzimet e veta. Mos hezitoni që të interesoheni tek policia ose një institucion i ndihmës për viktima. Këta mund t'ju japin informacione të mëtejshme.

Në internet ju mund të gjeni po ashtu shumë informacione për shoqërimin psiko-social nën [→ www.hilfe-info.de](http://www.hilfe-info.de).

### **A mund t'i bashkohem unë procesit penal si paditëse dytësore respektivisht paditës dytësor?**

Nëse ju jeni bërë viktimë e veprave të caktuara penale, ju mund të paraqiteni si paditëse dytësore respektivisht paditës dytësor. Këtu përfshihen p.sh. përdhunim, abuzim seksual, vrasje në tentativë ose një vepër që ka çuar në vrasjen e një të afërmi të ngushtë. Në një rast të tillë ju keni të drejta të veçanta, p.sh. avokatja juaj ose avokati juaj mund të marrin për ju shikim në dosjet penale pa arsytim të veçantë dhe mund të paraqesin kërkesa në çdo moment të procesit. Përveç kësaj, ndryshe nga dëshmitaret dhe dëshmitarët e tjerë, ju mund të merrni pjesë parimisht gjithmonë në shqyrtimin gjyqësor.

### **Kush e paguan avokaten time ose avokatin tim?**

Nëse ju e shfrytëzoni ndihmën avokatore, atëherë juve mund t'ju shkaktohen shpenzime. Nëse i pandehuri respektivisht e pandehura do të dënohet, atëherë ai respektivisht ajo duhet t'i marrë përsipër shpenzimet. Por jo të gjithë të dënuarit janë edhe në gjendje që t'i paguajnë shpenzimet. Prandaj mund të ndodhë që ju duhet t'i paguani atëherë vetë shpenzimet.

Në raste të veçanta të përjashtimit ju mund të kërkonte tek gjykata që të merrni një avokate respektivisht një avokat me shpenzimet e shtetit. Kjo është kështu p.sh. në rastet e rënda të dhunshme ose seksuale ose nëse të afërm të ngushtë, p.sh. fëmijë, prindër ose bashkëshortja respektivisht bashkëshorti e kanë humbur jetën për shkak të veprës penale. Në këtë rast nuk ka rëndësi, nëse ju keni apo jo pasuri.

Edhe në raste të tjera ju mund të kërkonte tek gjykata ndihmë financiare për këshillimin avokator. Kjo mund të ndodhë, nëse ju keni të ardhura tepër të vogla dhe keni të drejtë që t'i bashkoheni procesit si paditëse dytësore respektivisht paditës dytësor.

### **Zhdëmtim dhe shpërblim për dëmin**

Ju keni pësuar nga një vepër penale edhe një dëm dhe dëshironi të merrni shpërblim për dëmin? Ju dëshironi që pretendimi juaj të merret në konsideratë direkt në procesin penal? Si rregull, kjo është e mundshme (i ashtuquajtur i adhezionit [procedurë e ngritjes së padisë civile në procesin penal]). Por për këtë ju duhet të paraqisni një kërkesë konkrete. Nëse dëshironi të paraqisni pretendime, na e njoftoni këtë në një fazë të hershme, më mirë gjatë paraqitjes së kallëzimit tuaj.

Natyrisht ju e keni të lirë edhe rrugën që ta kërkonte zhdëmtimin ose shpërblimin për dëmin në një proces tjetër, d.m.th. jo para gjykatës penale, por para gjykatës civile.

Në të dyja rastet ju mund të kërkonte tek gjykata ndihmë financiare për këshillimin avokator, nëse ju keni të ardhura tepër të vogla.

### **Cilat të drejta kam unë përveç kësaj?**

Ju keni pësuar nga një vepër e dhunshme dëme shëndetësore? Atëherë ju mund të merrni përfitime nëpërmjet Ligjit për dëmshpërblimin e viktimave, p.sh. kur bëhet fjalë për trajtime mjekësore ose psikoterapeutike, furnizimin me mjete ndihmëse (p.sh. mjete ndihmëse për të ecur, karrocë me rrota) ose përfitime pensionale (p.sh. kompensim të humbjeve të të ardhurave). Gjatë paraqitjes së kallëzimit tuaj ju mund ta pyesni policinë për këtë. Kjo mund t'ju ndërmjetësojë në autoritetin kompetent.

Pa paraqitje paraprake të kërkesës, ju mund t'i drejtoheni një ambulance të traumës, për të marrë mbështetje psikoterapeutike shpejt dhe pa komplikime, nëse keni nevojë akute.

Nëse ju jeni viktimë e një veprë terroriste ose ekstremiste, ju mund të kërkonte ndihmë financiare tek Zyra Federale e Drejtësisë. Atje i mësoni të gjitha për kushtet dhe për procedurën: → [www.bundesjustizamt.de](http://www.bundesjustizamt.de) (fjalë kërkimi: Bürgerdienste → Härteleistungen)

Si viktimë e dhunës shtëpiake juve ju takojnë ndoshta të drejta të tjera sipas Ligjit mbi mbrojtjen nga dhuna. Ju mund të kërkonte p.sh. tek Gjykata Komunale (gjykatës familjare), e cila i ka ndaluar autorit respektivisht autores që të lidhë kontakt me ju. Nën kushte të veçanta gjykata mund të lejojë që ju të mund të përdorni tani vetëm një banesë, të cilën e keni banuar

deri tani së bashku me autorin respektivisht autoren. Kërkesat e nevojshme ose mund t'i paraqisni me shkrim tek Gjykata Komunale, ose mund t'i regjistroni kërkesat atje direkt në vend. Ju nuk duhet të përfaqësoheni nga një avokate ose një avokat.

Eventualisht mund të ekzistojnë edhe pretendime ndaj sigurimit ligjor ndaj aksidenteve. Ky mund të jetë rasti nëse ju p.sh. e keni ndjekur veprimtarinë tuaj profesionale, keni udhëtuar me një klasë shkolle ose një grup seminari universitar ose donit të ndihmonit persona të tjerë në raste fatkeqësie ose emergjence dhe jeni plagosur gjatë kësaj. Një pasqyrë mbi arkat e aksidenteve dhe kooperativat e sigurimit për aksidente profesionale ju gjeni në faqen e internetit të sigurimit ligjor gjerman të aksidenteve nën → [www.dguv.de](http://www.dguv.de) (→ Versicherung → Zuständigkeit).

### **Çfarë është një kompensim viktimë-autor?**

Kompensimi viktimë-autor duhet ta ndihmojë viktimën e një vepre penale, ndër të tjera, që ta përballojë të padrejtën e pësuar. Më intensivisht sesa në procesin penal normal një autor respektivisht një autore duhet të merret krejt konkretisht me këtë në bisedë personale se cilat dëme dhe plagosje, vepra e tij respektivisht e saj, ka shkaktuar tek viktima. Kjo mund të lidhet me dëmin material, të cilin një viktimë e ka pësuar nga një vepër penale, ose me lëndime shpirtërore, fyerje personale dhe frika të shkaktuara nga vepra. Biseda zhvillohet zakonisht me pjesëmarrjen e një personi të trajnuar të ndërmjetësimit, por me dëshirë edhe pa një takim personal dhe vetëm përmes personit ndërmjetësues.

Por një kompensim autor-viktimë nuk kryhet asnjëherë kundër vullnetit të viktimës dhe ai kryhet vetëm atëherë, nëse autori respektivisht autorja dëshiron seriozisht që të marrë përsipër përgjegjësi për veprën. Në raste të përshtatshme një kompensim autor-viktimë mund t'i shërbejë përballimit të vetëvendosur të konfliktit nga ana e viktimës dhe rivendosjes së paqes ligjore. Shpesh herë kjo procedurë sugjerohet tashmë nga prokuroria ose policia. Por ajo nuk i përket procesit të mirëfilltë penal dhe kryhet jashtë procesit penal. Për këtë ka zyra dhe institucione të veçanta, të cilat vënë në punë ndërmjetëse dhe ndërmjetës të kualifikuar.

Informacione të mëtejshme për kompensimin autor-viktimë dhe për institucionet, të cilat e kryejnë në afërsinë tuaj, ju gjeni në internet p.sh. nën → [www.toa-servicebuero.de/konfliktschlichter](http://www.toa-servicebuero.de/konfliktschlichter) ose gjithashtu nën → [www.baq-toa.de](http://www.baq-toa.de)

## Broshura dhe linqe që çojnë më tej

Informacione rreth mbrojtjes së viktimave ju gjeni nën [www.hilfe-info.de](http://www.hilfe-info.de) Informacione të tjera ndihmuese ju gjeni, ndër të tjera, në këto broshura:

- [Opferfibel \[Fibula e viktimave\]](#)
- [Unë kam të drejta](#)
- [Më shumë mbrojtje në rast të dhunës shtëpiake \[Më shumë mbrojtje në rast të dhunës shtëpiake\]](#)
- „Beratungs- oder Prozesskostenhilfe“ [Ndihma për kostot e këshillimit ose procesit]  
të gjitha nën [www.bmj.de/Publikationen](http://www.bmj.de/Publikationen)
- [Hilfe für Opfer von Gewalttaten \[Ndihmë për viktimë nga vepra të dhunshme\]](#)  
nën [www.bmas.de/opferentschaedigung](http://www.bmas.de/opferentschaedigung)

**Porosi e publikimeve:**

[www.bmj.de](http://www.bmj.de)

**Publikationsversand der Bundesregierung [Dërgimi i publikimeve të qeverisë federale]:**

Kutia postare 481009

18132 Rostock

Telefon: (030) 18 272 272 1

Faks: (030) 18 10 272 272 1

## **Ekzistojnë disa qendra kontakti dhe këshillimi për viktimat e krimëve në Niedersachsen:**

Mbështetja është në dispozicion për të gjithë viktimat e krimëve dhe familjet e tyre dhe është pa pagesë. Specialistët e trajnuar posaçërisht punojnë në qendrat e kontaktit dhe këshillave të përmendura më poshtë. Ata kanë përvojë me njerëzit në situatën e Juaj. Ata ju dëgjojnë dhe ju ndihmojnë. Në varësi të nevojave tuaja, ata gjithashtu do t'ju ofrojnë ndihmë të mëtejshme dhe do t'ju japin informacione për shembull për temat:

- Ndihma të shpejta psikoterapeutike përmes klinikave ambulatorë të traumave,
- Aplikimet sipas Ligjit Gewaltschutzgesetz,
- Dokumentim i provave të dhunës në familje dhe/ose seksuale, pavarësisht nga një reklamë me policinë (Rrjeti ProBeweis),
- Reklamë penale dhe ankesë penale,
- Informacione mbi procedurën penale,
- Tregim dëshmitari,
- Shoqërimi i dëshmitarëve,
- Bashkë-paditës,
- Kompensim dëmi ose kompensim parash për dhimbjen (Procedura e ngjitjes),
- Mundësitë e mbështetjes financiare,
- Kompensimi veprimtari-viktimë dhe
- Mbështetje për barrierat gjuhësore (gjithashtu përkthim në gjuhën e shenjave etj.).

### **Fondacioni Opferhilfe Niedersachsen me 11 zyra mbështetëse të viktimave**

Informacione mbi ofertat dhe të dhënat e kontaktit të zyrave Ju i gjeni në:

[www.opferhilfe.niedersachsen.de](http://www.opferhilfe.niedersachsen.de)

Telefon: 0441/220-1111.



### **Mbështetja psikosocial në proces**

Mbështetja në proces është një mbështetje veçanërisht intensive për viktimat e krimit në procedurën penale. Ju mund të gjeni informacione në:

[www.justizportal.niedersachsen.de/Prozessbegleitung](http://www.justizportal.niedersachsen.de/Prozessbegleitung)

Telefon: 0511/120-8728.



Do të merrni gjithashtu informacione dhe mbështetje të mëtejshme këtu:

### **Geschäftsstelle des Niedersächsischen Landesbeauftragten für Opferschutz**

Informacione mbi ofertën qendrore të këshillimit dhe vendosjes dhe kontaktin me zyrën e përfaqësuesit të shtetit i gjeni në:

[www.mj.niedersachsen.de/opferschutzbeauftragter](http://www.mj.niedersachsen.de/opferschutzbeauftragter)

Telefon: 0511/120-8737.



**WEISSER RING e.V. me 41 zyra degësh në Niedersachsen**

Informacione mbi ofertat e WEISSEN RING e. V. dhe mbi zyrat e degëve në Niedersachsen i merrni në:

[www.niedersachsen.weisser-ring.de](http://www.niedersachsen.weisser-ring.de)

Telefoni i viktimave: 116 006 (pa pagesë).



Një përmbledhje, informacione të përgjithshme në lidhje me të drejtat Tuaja dhe mbështetjen Tuaj, si dhe një përmbledhje e qendrave të kontaktit dhe këshillave në Niedersachsen janë në dispozicion në

[www.opferschutz-niedersachsen.de](http://www.opferschutz-niedersachsen.de)

